

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

Nr.Rendor	Data e kërkesës	Objekti I kërkesës	Përgjigje	Tarifa
1.	19/01/2023	Lenda: Kërkesë për informacion mbi aktivitetet e realizuara gjate vitit 2022 per zvogelimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile Dergues: AKMC	Në përgjigje të shkresës suaj, me nr.140/1 Prot.datë 19/01/2023, protokolluar me tonën me Nr.80 Prot, datë 24.01.2023, me lëndën "Kërkohet informacion për aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2022 për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile", Instituti i Shëndetit Publik në lidhje me kuadrin ligjor në fuqi ka realizuar pikat si më poshtë vijon: -Përsa i përket pikës 2 lidhur me buxhetin e planifikuar ISHP nuk ka kryer shpenzime buxhetore mbi aktivitetet për emergjencat civile gjatë 2022. -Për pikën 4 janë hartuar planet e emergjencave sipas fushës së përgjegjësisë, janë përgatitur planet si më poshtë: 1.Emergjenca e COVID-19 dhe shtamet e reja qarkulluese; Plani strategjik i veprimit ndaj COVID-19 2. Emergjenca e COVID-19 dhe shtamet e reja qarkulluese; Plani Kombëtar i Vaksinitimit ndaj COVID-19 3.E mergjenca e gripit sezonal: Plani i përgatitjes ndaj gripit sezonal dhe virozave respiratore dhe vaksinitimit ndaj gripit sezonal	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>4. Emergjenca e rezistencës antimikrobike: Plani strategjik për rezistencën antimikrobike dhe survejancën e saj.</p> <p>5. Emergjenca nukleare si pasojë e luftës në Ukrainë; Draft-Plani i mbrojtjes së shëndetit të popullatës nga rreziqe nukleare</p> <p>6. Emergjenca nukleare si pasojë e luftës në Ukrainë: Draft-Plani i përgjigjes për rreziqet ndaj sëmundjeve infektive dhe vaksinimit për krizën e refugjatëve nga Ukraina</p> <p>7. Emergjenca e Lisë së Majmunit: Draft-Plani i përgjigjes ndaj Lisë së Majmunit</p> <p>8. Emergjenca e Lisë së Majmunit: Draft-Plani i vaksinimit ndaj Lisë së Majmunit</p>	
2.	30/01/2023	Lënda: Kërkohej informacion Dërgues: AKMC	<p>Në përgjigje të shkresës suaj nr.244/1, datë 30.01.2023, protokolluar me tonën Nr. Prot 115 datë 01.02.2023 ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:</p> <p>Në Institutin e Shëndetit Publik për vitin 2022 janë raportuar 122224 testime të rezultuara pozitiv për COVID-19. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale numri i vdekjeve për vitin 2022 është 371 raste.</p>	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

3.	02.02.2023	Lënda: Kërkesë për informacion Dërgues:Piranjat	<p>Mbështetur në kërkesën e bërë nga Piranja, drejtuar institucionit tonë me shkresë, me numrin tonë të protokollit Nr.112, datë 02/02/2023, me temë "Kërkesë për informacion", ju bëjmë me dije se: Në përgjigje të pyetjes suaj të parë, ISHP nuk kryen matje për rrezatimin jo jonizues por i merr të dhënat nga matjet e kryera nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike Postare. Raportet e monitorimeve të nivelit të rrezatimeve gjenden të publikuara në faqen zyrtare të AKEP.</p> <p>Në vijim të përgjigjes për pyetjen e dytë, ISHP bën vetëm përpunimin dhe analizimin e të dhënave. Duke qënë se të gjitha matjet janë në normë, nuk ka pasur impakt negativ në shëndetin publik.</p> <p>Në përgjigje të pyetjes së tretë, ISHP monitoron dëmtimet nga rrezatimi jonizues dhe jo jonizues nëpërmjet monitorimit të sëmundshmërisë nga survejanca epidemiologjike, deri më tani nuk kemi asnjë pacient të raportuar si të dëmtuar nga rrezatimi jonizues dhe jo jonizues. Për sa i përket monitorimit të ekspozimit mbi punonjësit e ekspozuar në ambientin e punës ndaj rrezatimit</p>	Nuk ka
----	------------	--	--	--------

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>jonizues, puna jonë bazohet të VKM Nr.80 datë 11/12/2019 nenin 30. Të gjithë punonjësit e ekspozuar ndaj rrezatimit jonizues në sektorin publik dhe privat duhet të paraqesin rezultatet e analizave të përfshira në ‘ ‘Listën me ekzaminime që duhet të bëjnë punonjësit e ekspozuar ndaj rrezatimit jonizues’ ose rezultatet e analizave të përfshira në ‘ ‘Kontrollin mjekësor bazë’’, ‘ ‘Kartelën shëndetësore të punëmarrësit dhe vlerësimit të riskut’ si dhe ti nënshtrohet vizitës mjekësore nga mjeku i ISHP-së me qëllim pajisjen me ‘ ‘Raportin e aftësisë në punë për punonjësit e ekspozuar ndaj rrezatimit jonizues’</p>	
4.	03/02/2023	<p>Lënda: Kërkesë për informacion Kërkues: Arbjona Celiku</p>	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju informojmë se ISHP ka bashkëpunuar me Agjensinë Kombëtare të Mjedisit për të kryer monitorimin e cilësisë së ajrit në disa qytete të vendit. Agjensia Kombëtare e Mjedisit disponon rezultate, ku të dhënat i publikon në raportet vjetore mjedisore, gjithashtu pranë AKM ju gjeni informacionin e nivelit të ndotjes ndër vite në Tiranë.</p>	Nuk ka
5.	11.05.2023	<p>Lënda: Kërkesë për informacion Kërkues: Znj.Esmeralda Keta</p>	<p>Bazuar në kërkesën tuaj Nr.396, datë 11.05.2023, për informacion</p>	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

		Top Channel	<p>mbi shëndetin mendor, ju vëmë në dijeni si më poshtë vijon: Në mbarë botën, rreth gjysma e të gjitha crregullimeve të shëndetit mendor fillojnë në moshën 14 vjec por shumica e rasteve nuk njihen dhe nuk trajtohen vecanërisht në vendet me të ardhura të ulta dhe të mesme si Shqipëria, me pasoja afatgjata jo vetëm në shëndetin mendor të adoleshentëve, por edhe për familjet e tyre dhe ekonominë kombëtare. Crregullimet mendore të diagnostikuara tek të rinjtë përfshijnë mungesë e vëmëndjes/hiperaktiviteti(ADHD, ankthin, depresionin, crregullimin e sjelljes, crregullimet e të ngrënit, crregullimin bipolar, paaftësinë intelektuale, autizmin dhe skizofreninë. Në vendin tonë, trendi i prevalencës së sëmundjeve mendore të bazuara në kujdesin shëndetësor parësor reflekton rritjen e ndërgjegjësimit të shoqërisë për shëndetin mendor. Në kuadrin e reformës kombëtare të shëndetit mendor, shërbimet për shëndetin mendor kanë synuar kujdesin komunitar dhe familjar, si dhe zgjerimin e kategorive të profesionistëve të përfshirë në shërbime më shumë disiplinore.</p>	
--	--	-------------	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), në kujdesin parësor ka përfshirë qendra socio-shëndetësore. Janë hapur 50 qendra shëndetësore të cilat tashmë ofrojnë dhe kujdes të integruar psiko-social, po ashtu dhe këtë vit (2023) po zgjerohen duke integruar dhe 50 qendra të tjera në kujdesin parësor me punonjës socilë dhe psikologë, duke i kthyer kështu për herë të parë strukturat e kujdesit shëndetësor dhe në mbështetje për kujdesin psiko-social për ato kategori që kanë më shumë nevojë me problematikat e shëndetit mendor. Monitorimin e shëndetit mendor në vendin tonë Instituti I Shëndetit Publik e kryen përmes analizës së përdorimit të shërbimeve shëndetësore dhe studimeve në popullatë. Janë kryer disa studime në popullatë në periudha të ndryshme, prej të cilëve Health Behaviour in School Children Survey dhe tashmë sistematik dhe i fokusuar vetëm te fëmijët. Ndërsa Albanian Demograpich and Health Survey është një studim që përfshin popullatën 15-59 vjec.</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>Lista e të gjithë anketimeve të kryera në Shqipëri që përfshijnë çështje të shëndetit mendor:</p> <ul style="list-style-type: none">-Albanian Demographic and health survey-Strengths and difficulties at adolescents in Tirana(2014)-Youth Risky Behavior Survey (2005&2010)-Health Behaviours in School age Children Survey 2013/2014&2017/18-The International Mobility in Aging Study in Tirana, 2014&2016 <p>Ka dokumente dhe plane strategjike të zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që trajtojnë çështjet e shëndetit mendor. Më të rëndësishmet janë si më poshtë:</p> <p>-Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030.</p> <p>Një nga objektivat strategjikë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për sektorin e Shëndetësisë është “Investimi në shëndetin e popullatës gjatë gjithë ciklit jetësor. Shëndeti i popullatës do të jetë në qendër të vëmendjes duke forcuar dhe zgjeruar programet e reja të vaksinimit,</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>duke reduktuar sjelljet e rrezikshme që prekin sëmundjet jo të transmetueshme, duke përmirësuar shëndetin e nënës dhe fëmijës, adoleshentëve dhe shëndetin riprodhues</p> <p>-Strategjia Kombëtare Shqiptare e Shëndetësisë 2021-2030.</p> <p>Është dokumenti strategjik më i rëndësishëm i MSHMS-së dhe një platformë gjithëpërfshirëse që koordinon të gjitha përpjekjet për përmirësimin e shëndetit dhe mirëqënies së të gjithë njerëzve në Shqipëri. Strategjia thekson se përfshirja dhe integrimi i shërbimeve të shëndetit mendor brenda brenda kujdesit shëndetësor parësor duhet të zbatohet duke përfshirë ndërlidhjen me ofruesit ekzistues të shërbimeve si Organizata Jo Qeveritare me qëllim forcimin e përgjigjeve locale dhe kombëtare ndaj çështjeve të shëndetit mendor. Investimet në shërbimet e shëndetit mendor, vecanërisht për të rinjtë dhe rritja e kapaciteteve lokale për të manaxhuar çështjet e shëndetit mendor nëpërmjet kujdesit shëndetësor parësor duhet të jenë prioritet.</p>	
--	--	--	---	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>-Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029. Për të fuqizuar të rinjtë për të ndërtuar të ardhmen e tyre të sigurt në Shqipëri qeveria shqiptare ka vendosur të mbështesë zhvillimin e një strategjie kombëtare për të rinjte. Një nga synimet e politikës së kësaj strategjie është 'Mirëqënia aktive, e shëndetëshme, fizike , sociale dhe mendore e të rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre, vecanërisht për ata të rinj që janë në një situatë të rrezikshme ose përjashtim social.</p> <p>-Plani i Veprimit Për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor në Shqipëri 2013-2022. Vëmendje e vecantë i kushtohet fuqizimit të shërbimeve për fëmijë dhe adoleshentë.</p> <p>-Drafti i ri i Planit Kombëtar të Veprimit për Shëndetin Mendor 2022-2026. Një kapitull i vecantë i kushtohet çështjeve të shëndetit mendor të të rinjve.</p> <p>-Paketa e trajnimit të bazuar në shkollë për profesionistët e shëndetësisë në shkollë është një mjet i Organizatës Botërore të Shëndetësisë që ofron informacion</p>	
--	--	--	--	--

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			dhe aftësi për adresimin e çështjeve kyce që lidhen me shëndetin e fëmijëve dhe adoleshentëve. Një nga çështjet që diskutohet gjerësisht në paketë është shëndeti mendor dhe mirëqënia e fëmijëve të moshës shkollore. Për më tepër , paketa e trajnimit përshkruan shkollat si mjedise të përshtatshme për promovimin e shëndetit mendor pozitiv. Këtë vit paketa e trajtimit është rishikuar dhe përditësuar nga Instituti I Shëndetit Publik dhe po përdoret në trajnime me personelin shëndetësor të shkollave në Tiranë.	
6.	21.06.2023	Lënda:Kërkesë për informcion Kërkues: Emisioni STOP	Në përgjigje të kërkesës tuaj datë 21.06.2023 drejtuar Institutit të Shëndetit Publik protokolluar me tonën nr.prot 634 datë 21.06.2023 ju bëjmë me dije si më poshtë vijon; Në lidhje me përzgjedhjen e specialistëve, në grupet e punës ISHP-ja ka ndjekur zbatimin e VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik" Neni 76 i ndryshuar dhe në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 "Për prokurimet publike". Në	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>grupet e punës janë përfshirë dhe specialistë të fushës duke zbatuar rregullat e legjislacionit të mësipërm</p> <p>2. Instituti I Shëndetit Publik ka përcaktuar një specialistë fushe për të qënë pjesë e KVO-së. Autoriteti që organizon procedurën e prokurimit është ASHPP, e cila në bazë të nenit 75 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” e ndryshuar , përcakton anëtarët e KVO-së.</p> <p>3.Për sa i përket përzgjedhjes së specialistëve sipas specializimeve, specialistët janë përzgjedhur sipas zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe natyrës së objektit të prokurimit sipas bazës ligjore.</p>	
7.		<p>Lënda: Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare. Dërgues: Zyra e Komisionerit</p>	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj per informacion datë 26.06.2023, protokolluar me tonën Nr. Prot.655 mbi ankimim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare ju bëjmë më dije si më poshtë vijon: Nga ana e koordinatores për të drejtën e informimit nuk ka një mungesë të kthimit të përgjigjes</p>	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>pasi kërkesa për informacion nga ana e Znj.Topi ka ardhur në Spam dhe e-maili për arsye sigurie nuk mund të hapej. Bashkangjitur gjeni fotot të e-mailit ardhur në spam. Përsa i përket kërkesës për informacion nga ana e Znj.Topi ju bëjmë me dije se procesi i dezinfektimit është në procedurë prokurimi pranë ASHPP. Me përfundimin e procedurës së prokurimit do të nis dhe procesi i dezinfektimit!</p>	
8.	21.07.2023	<p>Lënda: Kërkesë për informacion Kërkues: Ora Tv</p>	<p>Mbështetur në kërkesën e bërë nga ana juaj drejtuar institucionit tonë me shkresë, me numrin e protokollit Nr.62, datë 19/07.2023, me numrin tonë të protokollit Nr.758, datë 21/07/2023 me temë “Kërkesë për informacion”, ju bëjmë me dije se: Në bazë të Ligjit Nr.16/2020” Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9863, datë 28.1.2008, “PER USHQIMIN”, të ndryshuar” dhe VKM nr.434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”, kontrolli në operatorët e biznesit ushqimor nuk është detyrë funksionale e këtij institucioni ndaj dhe ky informacion nuk mund të</p>	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			ofrohet nga Instituti i Shëndetit Publik.	
9.	18.09.2023	Lënda: Kërkesë për informacion Kërkues: Esmeralda Keta	Znj.Esmeralda Keta i është kthyer përgjigje me anë të e-mailit dhe i janë vënë në dispozicion të gjitha materialet e kërkuara.	Nuk ka
10.	12.09.2023	Lënda: Kërkesë për informacion Kërkues: BIRN	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin të vënë në dispozicion nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive/Spektori i Kontrollit të Infeksioneve Spitalore të renditur si më poshtë: 1. Protokoll mbi Principet e Infeksioneve Spitalore dhe Sterilitetit të Sallave Operatore (Nëntor 2007) 2. Protokoll për Kontrollin dhe Parandalimin e Infeksioneve spitalore (Mars 2012) 3. Aktiviteti i ekzaminimeve mbi ndotjen mikrobiale në mjediset e kujdesit shëndetësor për periudhën (2012-2014) 4. Aktiviteti ekzaminimeve mbi ndotjen mikrobiale në mjediset e kujdesit shëndetësor për periudhën (2016-2017) 5. Aktiviteti ekzaminimeve mbi ndotjen mikrobiale në mjediset e kujdesit shëndetësor për periudhën (2018)	Nuk ka

REGJISTËR I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR 2023

			<p>6. Aktiviteti ekzaminimeve mbi ndotjen mikrobiale në mjediset e kujdesit shëndetësor për periudhën (2022-2023)</p> <p>7. ”Infeksionet Spitalore Sfida për tu fituar”</p> <p>8. Artikuj të ndryshëm ndër vite</p> <p>9. Prezantimet e vlerësimit të infeksioneve spitalore (Korrik 2023)</p>	
11.	Gjate muajve Tetor, Nentor dhe Dhjetor nuk ka pasur kerkesa per informacion			Nuk ka